



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**

NR. REGJISTRIT THEMELTAR 814

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Sot me date **23.05.2017**, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e perbere prej:

Gjyqtar Arjana LIÇO

asistuar prej sekretares gjyqësore Berzana Çobo, mori në shqyrtim ne seance gjyqësore me dyer te hapura ceshtjen penale Nr. **814** Regj.Them, qe i përket paleve:

KERKUES:

M... sh.p.k, identifikuar nga Numr Nipt L5...4G, me adrese ..., Kruje, perfaqesuar nga administratorja Znj. S. P.S. P.me nr.kontakti 068 ...51, përfaqësuar me Prokurë të Posacme Nr.414Rep., Nr.157Kol., dt.12.05.2017, nga Av.Arjola Sheri me Nr.4189license, Nipt L22127002K..

PERSON I TRETE:

Prokuroria pranë Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, perfaqesuar nga Prokurori Ndini TAVANI..

OBJEKTI:

Ankim kundër vendimit te Prokurorit Z. Ndini Tavani, date 21.04.2017, per “Sekuestrimin e sendeve”, ne kuader te procedimit penal nr.2969/2017 te Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

BAZA LIGJORE:

Neni 212, 214, 217, i Kodit te Procedures Penale, Neni 412, 413 i Kodit te Procedures Penale

Gjykata administroi provat e nevojshme, si dhe degjoi palen kerkuese e cila kërkoj Shfuqizimin e “Vendimit Sekuestrimin e sendeve”, dt.21.04.2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër shoqërisë tregëtare “M...”, me Nipt **L5...4G**, në kuadër të procedimit penal Nr.2969/2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe palen e trete Prokuroria pranë Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane përfaqesuar nga prokurori Ndini Tavani që kerkoi rrëzimin e kësaj kërkesë. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata, pasi cmoi provat dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane mbi bazen e kallezimit të shtetasit B. Rr.si dhe nga administrimi i materialit referues, ka regjistruar procedimin penal nr.2969 të vitit 2017, për veprën penale "Mashtrimi", parashikuar nga neni 143/2, të Kodit Penal, në ngarkim të shoqërisë "T. M. W.", shoqëri tregëtare me Nipt K9...5V, me administrator Z. Th. T..

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Me datë 04.11.2009 është themeluar shoqëria T. M. W., i pajisur me NIPT K9...5V. Ky subjekt ka objekt të ushtrimit të aktivitetit të tij 'dhenien me qera të kamionave dhe makinerive të zotëruara. Shërbime të menaxhimit të projekteve për germime dhe mimera. Shërbime të supervizionit dhe menaxhimit të shfrytëzimit të M.... Me datë 23.07.2014 është emëruar administrator i këtij subjekti shtetasi Th. T..

Me datë 07.01.2013 midis subjekteve T. M. W. shpk dhe M.Rr. shpk, është lidhur kontrata e furnizimit për mallra.

Shoqëria M... shpk, është themeluar me datë 03.11.2015 dhe është pajisur me NIPT L 5...4G. Objekt i ushtrimit të aktivitetit të këtij subjekti është " *shërbimet e germimit dhe të M..., xheroreve dhe agregateve të tjere, tregëtimi i makinerive dhe artikujve të tjere industriale me shumicë dhe pakicë. Përdorimi i lendeve shpërthyesë dhe eksplozive në procesin e shërbimit të germimit dhe të M...".* Ortakë e vetme e këtij subjekti, është shtetasja greke E. S. dhe administratore shtetasja greke S. P..

Asambleja e ortakëve të shoqërisë T. M. W., me datë 01.12.2015 ka vendosur miratimin e transferimit aktual të shoqërisë në favor të shoqërisë M... shpk.

Me datë 09.12.2015, midis subjekteve T. M. W. shpk dhe M... Shpk, është lidhur kontrata e marrëveshjes së bashkëpunimit për transferimin e aktivitetit. Sipas kësaj kontrate vlera totale e aseteve të transferuara do të jetë 137.714.357 leke dhe vlera totale e detyrimit të transferuar do të jetë 137.560.000 leke. M... shpk, i detyrohet T. M. W. shpk, vlerën 154.358 leke. Shoqëria M... shpk ka detyrimin të shlyejë të gjithë detyrimin prej 137.560.000 leke. Bashkëlidhur kontratës, ndodhet dhe lista e plote e makinerive të transferuara nga T. M. Wshpk, të M... shpk. Me datë 01.12.2015, midis këtyre dy subjekteve, është përpiluar fatura tatimore e shitjes për transferimin e aktivitetit, sipas marrëveshjes të datës 09.12.2015 në vlerën 104.010.807 leke.

Me datën 27.04.2017, përmes Procesverbalit Për lenien në ruajtje të sendeve të sekuestruara, pala kërkuese ka marrë dëni për vendimin e Prokurorit, për sekuestrimin e sendeve, të datës 21.04.2017, në kuadër të procedimit penal nr.2969/2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

Në vendimin dt.21.04.2017 është vendosur:

- *Të sekuestrohen pranë Shoqërisë M... shpk pasuritë sipas kësaj liste.*

*Eskavator i përdorur Katerpillar 385C
Eskavator Libher*

*Sonda L8
 Buldozier Katerpilar D8
 Kamion Terex
 Eskavator Cat 345 B
 Roller Ham 3518 (H1760693)
 Terex T7831324
 Dumper Terex Tr 100
 Kamion Dumper Terex
 Makine vetelevizese Katerpilar 950 GLL
 Dumper Katerpilar 773 B
 Dumper Katerpilar B 2
 Katerpilar 992 C
 Drilled Machine BPI 123 (132)
 Kamion Cisterne MAN i perdorur M 06-18232
 Kat 938 F
 Konteniere
 Kamion cisterne Skania
 Toyota Hilux Tornado
 Kontenier i perdorur
 Fiat dobro 2004
 Toyota Hilux 4x4*

- *Sendet te ruhen prane ambienteve te Shoqerise M... shpk, pa te drejten per ti tjetersuar ato dhe per ti levizur nga vendi i ushtrimit te aktivitetit ... Kruje, ambientet e A... C..., sk 2957 nr. Pasurie*
- *Nje kopje e ktije vendimi te dergohet per njoftim DPSHTR Tirane per te bere shenimet e nevojshme per moskryerjen e veprimeve me dosjet e mjeteve ne pronesi te T. M. W. shpk dhe M... shpk sipas kesaj liste.*
- *Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohen oficeret e policise gjyqesore Andri Dervishi dhe Klevis Cifligu, me mbeshtetjen e punonjesve te Policise te Komisariatit te Policise Kruje”.*

Më dt.27.04.2017, sipas “Procesaverbal për lënien në ruajtje të sendeve të sekuestruara”, pala pala kërkuese ka marrë dijeni për vendimin e dt.21.04.2017, dhe ka paraqitur para gjykatës brenda afatit ligjor, më dt.03.05.2017(dt.01.05.2017 dhe 02.05t.2017 ditë pushimi), ankim ndaj këtij vendimi.

Pala kërkuese pretendoi se:

Kodi i Procedures Penale lejon marrjen e vendimit te sekuestrimit nga ana e Prokurorit, ky vendim duhet patjetër te marre miratimin nga ana e Gjykates.

Vendimi duhej ti vihej ne dispozicion pales ne rastin konkret shoqerise M... sh.p.k ne gjuhen ametare te administratores se kesaj shoqerie e cila eshte S. P., shtetase Greke.

Ne rastin objekt gjykimi ne asnje moment nuk ndodhemi para nje dispozite te parashikuar nga Kodi Penal, por para nje kazusi teresisht civil dhe si i tille nuk ndodhemi para provave materiale qe lidhen me ndonje veper penale.

T. M. W. sh.p.k, ne referim te te gjitha dispozitave ligjore ne fuqi (Ne referim te Nenit 5 te Ligjit per Shoqerite Tregtare, ne referim te Neni 16 te Ligjit "Per TVSH" transferimi i veprimtarise ekonomike; ne referim te Neni 21 te Udhezimit "Per TVSH" transferimi i veprimtarise ekonomike) ka nenshkruar Marreveshjen e Transferimit te Aktivitetit me Nr. ... date 9.12.2015 si dhe shtojcen e saj me shoqerine M... sh.p.k. Ne lidhje me kete kontrate tek Detyrimet e Paleve parashikohet se shoqeria T. M. W. sh.p.k merr persiper transferimin e aktivitetit si dhe te pronesise se aseteve te luajtshme me vlere Neto 10.010.807 leke si dhe te drejtat ndaj klientit per arketim ne vleren 33.703.550 leke si dhe detyrimet prej 137.560.000 leke. Shoqeria M... sh.p.k eshte nje shoqeri e krijuar sipas te gjitha ligjeve ne fuqi dhe nuk i detyrohet jo vetem shoqerise M. Rr. sh.p.k por as edhe nje personi, fizik, juridik, shteteror etj.

Midis shoqërisë T. M. W. sh.p.k dhe shoqërisë M. Rr. sh.p.k është një konflikt gjyqësor Civil ku në **referim te Vendimit me Nr. 2277, date 3.11.2016 te Gjykates se Apelit Tirane** eshte vendosur prishja e Vendimit Nr. 615, date 9.12.2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kruje dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim ne po ate gjykate me trup tjetër gjykues, pra gjykimi civil nuk është përfunduar.

Nese pretendohet qe veprimi juridik Marreveshja e Transferimit te aktivitetit eshte bere me qellim shmangien e ekzekutimit te Vendimit Nr. 343 date 12.03.2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kruje, ne kete rast ndodhemi para nje mosmarrveshje te paster civile dhe Kodi Civil ka parashikuar mjetet juridike qe perdoren nga ana e kreditorit qe eshte padia per kundërshtimin e veprimeve juridike te debitorit Neni 607 te Kodit Civil.

Duke pretenduar se Vendimi për "Sekuestrimin e sendeve", dt.21.04.2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër shoqërisë tregëtare "M..." , është marrë në kundërshtim me ligjion dhe sjell pasoja shume te renda per nje shoqeri me investitore te huaj, duke i bllokuar aktivitetin tregtar, duke i sjelle mungese likuiditeti, pamundesi per te paguar punonjesit etj, k pala kërkuese ka kërkuar shfuqizimin e tij.

Prokurori Ndini Tavani kërkoj lenien në fuqi të vendimit date 21.04.2017, per "Sekuestrimin e sendeve", ne kuader te procedimit penal nr.2969/2017.

Gjykata cmon se kërkesa është e bazuar në prova e ligj dhe si e tille duhet pranohet për sa më poshtë:

Në vendimin e saj Nr.12/2010, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se:

"...e drejta themelore e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se "...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit" ose, "...nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë ". Si e tillë, e drejta e ankimit përbën një nga të drejtat themelore të njeriut dhe ajo parashikohet edhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Protokollet e saj shtesë. Referuar dispozitave të këtyre dokumenteve dhe sipas nenit 43 të Kushtetutës është e qartë që "të drejtën e ankimit" për në instancat më të larta gjyqësore e gëzon çdo individ që është gjykuar nga gjykatat. Kjo shënon një standard më të lartë në mbrojtjen e të

drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ai i “ankimit efektiv” që përcaktohet në nenin 13 të Konventës, nën që pranon si respektim të standardeve të Konventës lejimin e ankimit efektiv në një instancë më të lartë pa e kushtëzuar domosdoshmërisht këtë ankimin me ankimin në instancat e tjera gjyqësore. Gjykata vlerëson se standardi i nenit 43 të Kushtetutës duhet të shihet i lidhur ngushtë me “të drejtën e apelit në çështjet penale” përcaktuar në nenin 2 të Protokollit 7 Shtesë të kësaj Konvente. Tejkallimin pozitiv të mësipërm Gjykata e ka vënë në dukje edhe në vendimin e saj nr.14 datë 05.07.2005, në të cilin është shprehur se, “...e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkallim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut”.

Në këto kushte gjykata mer në shqyrtim ankimin e bërë nga pala kërkuese, e cila çënohet direct nga vendimi date 21.04.2017, per “Sekuestrimin e sendeve”, ne kuader te procedimit penal nr.2969/2017, megjithëse procedimi penal nr.2969 të vitit 2017, per veprën penale “Mashttrim”, parashikuar nga neni 143/2, të Kodit Penal, është në ngarkim të shoqërisë “**T. M. W.**” .

Nese pretendohet qe veprimi juridik Marreveshja e Transferimit te aktivitetit eshte bere me qellim shmangien e ekzekutimit te detyrimit, ne kete rast ndodhemi para nje mosmarrveshje te paster civile dhe Kodi Civil ka parashikuar mjetet juridike qe perdoren nga ana e kreditorit qe eshte padia per kundërshtimin e veprimeve juridike te debitorit, Neni 607 te Kodit Civil sipas te cilit:

Kreditori ka të drejtë të kërkojë që të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori me qëllim që të pakësojë sasinë ose vleftën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur më parë se të jetë kryer veprimi juridik.

Kur veprimi juridik është bërë me kundërshtpërblim, duhet që edhe personi, me të cilin debitori ka kryer këtë veprim, të ketë patur dijeni për qëllimin e dëmtimit të debitorit. Por kur ky person është bashkëshort, prind, gjysh, fëmijë ose fëmijë e fëmijës, vëlla ose motër e debitorit, dijenia e qëllimit të dëmtimit prezumohet, gjersa të provohet e kundërta.

Me deklarimin e veprimit juridik si të pavlefshëm, nuk çënohen të drejtat që kanë fituar me kundërshtpërblim personat e tretë me mirëbesim para ngritjes së padisë për deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik”.

Si edhe rezulton nga provat e administruara, Kontrata e transferimit është bere disa here pjese e shqyrtimeve gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kruje, Tirane dhe ajo e Apelit, dhe si te tilla ne asnje moment keto Gjykata nuk kane konsideruar si te paligjshme kete kontrate. Po keshtu permes Vendimit me Nr. ..., date 19.12.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kruje duke marre ne shqyrtim Kontraten e Transferimit me Nr. ... ka çmuar qe kjo kontrate

është në përputhje të plote me ligjin në fuqi dhe i ka njohur pronesinë e mjeteve shoqërisë M... sh.p.k.

Gjithashtu Kontrata e Transferimit si të gjitha veprimet e tjera të shoqërive nuk kanë penguar asnjë ekzekutim, pasi rezultoi e provuar, se si nga ana e përmblyesve gjyqësor është ekzekutuar vendimi Nr. ..., datë 12.03.2015, provuar kjo përmes procesverbaleve të sjella në cilësinë e provës për këtë gjykim.

Gjykata cmon se nga Vendimi për sekuestrimin e mjeteve, dt.21.04.2017, të organit të akuzës, vijne pasoja shumë të rënda për një shoqëri në kërkues me investitorë të huaj, duke i bllokuar aktivitetin tregtar, duke i sjellë mungesë likuiditeti, pamundësi për të paguar punonjësit etj, dhe nuk ka sjellë asnjë doli për hetimin penal, i cili është në ngarkim të një shoqërie tjetër. Mjetet e vena në sekuestro nuk janë pronë e shoqërisë "T. M. W.", pasi ato janë pronë e shoqërisë tregëtare "M...", me Nipt L5...4G, e cila vecmas ushtron veprimtari tregëtare.

Në këto kushte për sa më lart gjykata arin në përfundimin se kërkesa është e bazuar në prova e në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të neneve 187, 188, 189, 212 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës ankimore:

Shfuqizimin e Vendimit për "Sekuestrimin e sendeve", dt.21.04.2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër shoqërisë tregëtare "M...", me Nipt L5...4G, në kuadër të procedimit penal Nr.2969/2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve, nga e nesërmeja e shpalljes.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.05.2017.

SEKRETARE
BERZANA ÇOBO

GJYQTARE
ARJANA LIÇO